



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës 18.12.2025 mori këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka mandat 4 vjeçar

Neni 3

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohen si vijon:

1. Fitim Shala, anëtar i Kuvendit -LDK
2. Gentianë Hoxhaj-Gashi anëtarë e Kuvendit -LDK
3. Hyra Bytyçi, anëtarë e Kuvendit -LDK
4. Yllëza Bedrolli, anëtarë e Kuvendit -PDK
5. Shahadije Bikliqi-Dragaçina ,anëtarë e Kuvendit -LVV
6. Fehmi Rexhepi, komuniteti ashkali
7. Maksut Gashi, komuniteti rom
8. Slavisa Trajkovic, komuniteti serb
9. Alush Bikliqi, komuniteti turk
10. Zoran Cirkovic, komuniteti malazez
11. Olga Gucic ,komuniteti kroat

Neni 5

Komiteti për komunitete në pajtim me dispozitat e nenit 53 par.53.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-020/04-68719

Lipjan, më 18.12.2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

